

VENDIM
Nr. 597¹, datë 31.8.2016

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “RIKONSTRUKSION I RRUGËS “MUJO ULQINAKU” DHE REHABILITIMI I FASADAVE”, FIER

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksion i rrugës “Mujo Ulqinaku” dhe rehabilitimi i fasadave”, Fier.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Fier.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë sipërfaqe “tokë truall” dhe “ndërtesë”, me një vlerë të përgjithshme të shpronësimit 2 403 668 (dy milionë e katërqind e tre mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 2 403 668 (dy milionë e katërqind e tre mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekësh, të përballohet nga llogaria “Fondi i shpronë-simeve”, në Bankën e Shqipërisë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Fier.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Fier, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier të pezullojë të gjitha tran-saksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier dhe Bashkia Fier për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

¹ VKM 597, datë 31.8.2016 është korrigjuar me Ndrejje gabimi nr. 39-1, datë 7.3.2017 në tabelën e pronarëve të shpronësuar, për pasurinë me nr. 38/883. Sipërfaqja e shpronësuar prej 218 m² do të ndahet në këto dy numra pasurie si më poshtë vijon:

- Pasuria nr. 3/82 shpronësohet për sipërfaqen 110 m² me pronarë Mynevere Gilani, Mimoza Sulkaj, Albana Gilani dhe Zebra Agalliu; dhe

- Pasuria nr.3/883 shpronësohet për sipërfaqe 108 m² me pronarë Mynevere Gilani, Mimoza Sulkaj, Albana Gilani dhe Zebra Agalliu, Fatbardha Kotoni dhe Adil Kotoni.

VLERËSIME PARAPRAKE PËR PASURITË PRONË PRIVATE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË REALIZIMIT TË PROJEKTEVE PËR INTERES PUBLIK

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E TË CILËVE DO TË SHPRONËSOHEN PËR REALIZIMIN E PROJEKTTT “RIKONSTRUKSION I RRUGËS “MUJO ULQINAKU” DHE HAPËSIRAVE PËRRETH SAJ DHE REHABILITIMI I FASADAVE” FIER

Nr.	Emër Mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. përgj. truallit (m²)	Sip. prekur truallit (m²)	Çmimi për truallin (lekë/m²)	Vlera e truallit (lekë)	Sip. totale ndërtesës me certifikatë (m²)	Sip. prekur ndërtesës (m²)	Amortizimi (%)	Vlera e ndërtesës me preventiv (lekë)	Vlera e përgjith. (lekë)	Gjendja juridike e pasurisë
1	Mynevere Alush Gilani & 5 b/pronare	8533	3/883	1,855.0	218.0	11,026	2,403,668	-	-	-	-	2,403,668	Konfirmim nga ZVPP-ja
Vlera totale												2,403,668	

Vlerësimi është bërë duke zbatuar VKM nr. 138, datë 23.3.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë për interes publik” dhe VKM nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.